

VENDIM
Nr. 539, datë 18.6.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1020, DATË 14.10.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT
TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 6 e 8, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian për Rregullat e Bashkë-punimit të Asistencës për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, dhe të neneve 10 e 11, të ligjit nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit të Asistencës e Paraanëtarësimit (IPA II)”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1020, datë 14.10.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin mbi sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës e Paraanëtarësimit (IPA).

3. Në ushtrimin e veprimtarisë Agjencia është funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët në sistemin e menaxhimit të decentralizuar/indirekt të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës e Paraanëtarësimit (IPA), në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombë-tarisht dhe me strategjinë e auditimit të Agjencisë.”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Fjalja e parë, e shkronjës “e”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“harton dhe paraqet te Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA/CAO) dhe Komisioni i BE-së, atëherë kur kërkohet zbatimi i marrëveshjes kuadër IPA, ratifikuar me ligjin nr. 9840, datë 10.12.2007 (këtu e në vijim referuar si marrëveshja kuadër IPA).”.

b) Pas shkronjës “P” shtohen shkronjat “g”, “gj” dhe “h”, me këtë përmbajtje:

“g) Harton dhe paraqet pranë Komisionit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga një kopje Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA/NIPAC) dhe Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO), raportet dhe opinionet, atëherë kur kërkohet zbatimi i marrëveshjes kuadër IPA II, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015 (këtu e në vijim referuar si marrëveshja kuadër IPA II):

i) Deri më 15 mars të çdo viti paraqet një opinion vjetor auditi sipas modelit të përcaktuar në shtojcën E të marrëveshjes kuadër IPA II, për raportet ose pasqyrat financiare vjetore dhe llogaritë vjetore të saj për vitin e kaluar financiar, që mbulojnë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, funksionimin e sistemit të menaxhimit, kontrollit dhe të mbikëqyrjes, si edhe ligjshmërinë e rregullsinë e transaksioneve në fjalë;

ii) Deri më 15 mars të çdo viti, së bashku me opinionin vjetor të auditit, paraqet një raport vjetor të aktiviteteve audituese sipas modelit në shtojcën D të marrëveshjes kuadër IPA II, ku

përcakton konstatimet nga auditet e kryera në përputhje me strategjinë e auditit gjatë periudhës në fjalë dhe mbështetjen e opinionit vjetor të auditit. Raporti vjetor i aktiviteteve audituese përcakton, ndër të tjera, çdo mangësi të konstatuar në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si edhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë apo të planifikuar nga Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA), Fondi Kombëtar dhe/ose strukturat operuese në fjalë;

iii) Paraqet një opinion auditit për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve që i dorëzohet Komisionit nga ZKA për mbylljen e çfarëdo programi ose të ndonjë pjese të tij. Ky opinion adreson vlefshmërinë e aplikimit për pagesën e fundit (përfundimtare) dhe saktësinë e informacionit financiar dhe, kur është e nevojshme, mbështetet nga raporti përfundimtar i aktivitetëve audituese. Ai bëhet sipas modelit të dhënë në aneksin F të marrëveshjes kuadër IPA II. Agjencia e dërgon opinionin brenda tre muajve pas dorëzimit të pasqyrës përkatëse përfundimtare të shpenzimeve nga ZKA.

gj) Përgatit strategjinë trevjeçare të auditimit, sipas modelit në shtojcën G të marrëveshjes kuadër IPA II, e cila përditësohet çdo vit. Agjencia paraqet strategjinë e auditit për tri vitet e ardhshme brenda muajit nëntor të çdo viti të Komisioni Evropian dhe një kopje të Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO)."

h) Për programet e bashkëpunimit ndër-kufitar, Agjencia kryen funksionet e saj në përputhje me parashikimet e nenit 77, të marrëveshjes kuadër IPA II."

3. Pika 5 shfuqizohet.

4. Pikat 6 dhe 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"6. Mënyra e organizimit të brendshëm, rregullat e sjelljes së personelit dhe çështje të tjera të lidhura me veprimtarinë e Agjencisë përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga ministri i Financave, me propozim të drejtorit.

7. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe të nëpunësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil."

5. Pikat 8 dhe 9 shfuqizohen.

6. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar, emërtesa "Këshilli i Menaxhimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës", shfuqizohet.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama